



TITULLI I PUNËS: ZYRTAR KRYESOR FINANCIAR DHE I THESARIT

10-02-2023

Nr. 863

ARGENTINË-A

Duke i raportuar Kryeshefit Ekzekutiv dhe Bordit të Drejtorëve, Zyrtari Kryesor Financiar dhe i thesarit do të jetë përgjegjës për menaxhimin e përgjithshëm të financave në KEK. Ai/ Ajo do të ndihmojë drejtpërdrejt KE-n për të gjitha çështjet strategjike financiare që lidhen me buxhetin, menaxhimin financiar, analizën e përfitimit dhe kostos, parashikimin e nevojave dhe sigurimin e fondeve të reja etj.

KË PO KËRKOJMË?

Ne jemi në kërkim të një profesionisti që është i pajisur me një qëndrim të uritur, por modest dhe njerëzor. Me fjalë të tjera, grupi ynë i përshtatet më së miri një pjesëtar i ekipit që e sheh suksesin si një arritje ekipore dhe dëshiron të mësojë vazhdimisht gjëra të reja.

ROLI JUAJ:

- Si pjesë e udhëheqjes së organizatës, nga ZKFTH pritet të jap mbështetjen e tij për vendimmarrjen strategjike dhe operacionale, përveç përmbushjes së përgjegjësisë tradicionale të kujdestarisë që ka të bëjë me qeverisjen, përputhshmërinë dhe kontrollin, dhe etiken e biznesit.
- Përmbushjen e përgjegjësisë të kujdestarisë duke siguruar pajtueshmërinë dhe kontrollin efektiv dhe reagimin për zhvillimet rregullative, duke përfshirë raportimin financiar, kërkesat për kapitalin dhe përgjegjësinë e korporatës.
- Merr përsipër përgjegjësitë e lidhshme strategjike se bashku me KE-ne dhe menaxherët e tjerë të lartë, duke siguruar që funksioni i financave mbështet biznesin në nivel strategjik dhe operacional.
- Angazhohet dhe komunikohet në mënyrë efektive me kolegët, investitorët, klientët, furnitorët, rregullatorët, dhe palët e tjera të interesuara të brendshme dhe të jashtme.
- Është përgjegjës për zbatimin e të gjitha dispozitave financiare dhe standardeve të kontabilitetit, ligjet e aplikueshme në Kosovë të cilat rregullojnë çështjet financiare dhe aktet normative të ndërmarrjes;
- Menaxhon dhe është përgjegjës për përpilimin e të gjitha planeve të departamentit të Financave dhe Thesarit, biznes planin, planin buxhetor si dhe përgatitjen e strategjisë afatmesme dhe afatgjate.
- Menaxhon punën e përgjithshme të divizionit dhe asiston Kryeshefin në caktimin e objektivave dhe zhvillimin e planit të punës për përmbushjen e këtyre objektivave si dhe harton planin e punës për Divizionin e Financave dhe Thesarit.
- Përgjegjës që pasqyrat financiare tremujore dhe vjetore të Korporatës të përgatiten në kohë sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar;
- Të përgatisë pasqyrat e Kompanisë për auditimin e fundvitit dhe të shërbejë si ndërlidhës me auditorët;
- Përgjegjës për depot dhe menaxhimin e stokut, duke synuar optimizimin e niveleve të stokut;
- Përgjegjës për zbatimin e ERP;
- Përgjegjës për marrëdhëniet me autoritetet rregullatore, kryesisht tarifat dhe raportimin;
- Mbikëqyr rreziqet e përgjithshme të kompanisë: financiare, operacionale, fiskale etj. dhe së bashku me pronarët e riskut ofron zgjidhje për reduktimin ose shmangien e rreziqeve dhe monitoron zbatimin e masave për zbutjen e rreziqeve.
- Kryen punë të tjera të kërkuara nga KE dhe Bordi dhe të cilat janë të nevojshme për funksionimin efektiv të financave të KEK-ut.
- ZKFTH i raporton KE-së dhe Bordit të Drejtorëve
- KPI-të kryesore janë EBITDA dhe pajtueshmëria me buxhetin.

Ai/ajo duhet të zotërojë aftësitë e nevojshme udhëheqëse dhe ndërpersonale, duke përfshirë komunikimin, të menduarit strategjik, menaxhimin e ndryshimeve, aftësitë analitike të zgjidhjes së problemeve dhe vendimmarrjes.

KËRKESAT E APLIKIMIT TË KANDIDATËVE

- Shkollimi Universitar nga Fakulteti Ekonomik, drejtimi financa dhe / ose kontabilitet, minimumi 240 kredit/ECTS;

- Të posedoj përvojë profesionale mbi pesë (5) vite në nivel të lartë menaxherial, nga fusha e financave dhe / ose kontabilitetit;
- Të plotësoj kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1. si dhe 17.2 dhe 17.3 të ligjit nr. 03/L-087 të ndërmarrjeve publike dhe plotësim ndryshimit të ligjit për ndërmarrjet publike nr. 04/L-111 neni 13;
- Të ketë shkathësi kompjuterike posaçërisht mbi sistemet e avancuara në fushën e financave/kontabilitetit;
- Të ketë integritet të lartë moral e profesional;
- Të ketë njohuri të mirë të gjuhës Angleze, në të folur dhe shkruar.

NE OFROJMË:

- Mundësi për të punuar në një nga industritë më të rëndësishme në vend dhe një nga shoqëritë aksionare më të mëdha;
- Një pagë shumë konkurruese 2500-2800+ € (në varësi të ekspertizës dhe përvojës së punës);
- Sigurim shëndetësor dhe mundësia e përfshirjes edhe e anëtarëve të familjes;
- Bonus vjetor tërheqës e bazuar në performancën individuale, në varësi të performancës së korporatës;
- Mundësi përdorimi i makinës së kompanisë, shpenzimet e telefonit dhe përfitime të tjera;
- Mundësi për zhvillim personal dhe profesional;
- Mundësi për të lënë gjurmën tuaj se si duhet të trajtohen gjërat në një biznes shumëmilionësh;

Njerëzit vijnë në Korporatën Energjetike të Kosovës për sfidën dhe kreativitetin, zgjidhjen e problemeve komplekse dhe zhvillimin e ideve të reja në një nga sektorët më të rëndësishëm në vend.

Në këmbim, ne ofrojmë paketë të mirë shpërblymje dhe kënaqësinë unike që vjen me përmirësimin e jetës në të gjithë vendin. Kënaqësia që vjen duke bërë një ndryshim domethënës. A tingëllon sfiduese për ju?

Në fazën e dorëzimit të aplikimit, të gjithë kandidatët duhet të dorëzojnë VETËM:

1. Letër motivuese
2. Formulari i aplikimit të KEK-ut
3. Një CV (jo më shumë se 3 faqe) dhe
4. Një kopje e ID/Pasaportës

Kandidatët që do të ftohen në intervistë duhet të dorëzojnë brenda një afati të arsyeshëm kohor dokumentet e mëposhtme:

- Dëshmi e përvojës së punës menaxheriale nga punëdhënësi
- Certifikatat e kualifikimit
- Vërtetim për të mos qenë nën hetim/dënime të mëparshme (jo më i vjetër se 6 muaj nga data e shpalljes) origjinal
- Deklarata nën betim (formulari do ofrohet nga Korporata Energjetike e Kosovës gjatë intervistës).

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve është 24.02.2023, aplikimet duhet të dërgohen me email në kek.bord@kek-energy.com, në titullin e emailit si më poshtë:

ZYRTAR KRYESOR FINANCIAR DHE I THESARIT

Ne veçanërisht inkurajojmë aplikantët femra dhe ato nga grupet minoritare që të dorëzojnë aplikimet e tyre.

Mandati i kësaj pozite do të jetë 4 vjeçar, ndërsa performanca e zyrtarit të lartë do t'i nënshtrohet vlerësimit të vazhdueshëm nga Bordi i Drejtorëve.

